

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?
ADRESA	https://tpz.al/po-tani-a-duhet-te-dorehiqet-veliaj-i332974
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 11:53:18 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 11:42:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9ed5910b9ad3d84a4dfa05bef14ea0c6daf97b3fa0de80075311c0ceb45e1d79
TEKSTI	2a3cad4d42295453a572e6099df9bc4ac8577e02caf892aceb0634e184302294
PAMJA	c37db5a3435c3bce17a2afb7d09249d4b03a741dcdcf04f0d88bd1cef440915b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4c3b12ffc6ea5b0ec789e1eefd5ed6614411d7ba75be61a5236a5874794e7a96
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5f8ef0f8d1c556c1a23c45b5f0b4a2927fefdb161a9dff8be1ca6faf0b0d4224
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4c3b12ffc6ea5b0ec789e1eefd5ed6614411d7ba75be61a5236a5874794e7a96>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FLASH!

13:50 Vendimet e KLGJ/ Paulin Çera ngrihet në detyrë në Gjykatën e Posaçme, Julian Haxhiu në Apel dhe Gentiana Xhelili në Administrative • 13:42 Po tani, a duhet të dorë?

IDE, 15 SEPTEMBER 2026, 13:42

Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?

tpz.al Nga Andi Bushati



Mes gjithë dyshimeve që ka ngjallur mbajtja e tij në një izolim të tejzgatur për një vit e gjysëm, Gjykata e Lartë ka vendosur se Erion Veliaj duhet të vazhdojë të qëndrojë në burg, pavarësisht se ajo Kushtetuese e ka njohur atë si kryebashkiak, të cilit i takon të ushtrojë funksionet e fituara me votë popullore.

Duke shfrytëzuar këtë situatë absurde të sistemit tonë të drejtësisë, Veliaj nuk la gurë pa lëvizur për ti vënë ata që do të merrnin vendimin për të ndaj një presioni të jashtëzakonshëm. Ai shtoi lobimin ndërkombëtar për të cilin deri më tani vetëm në SHBA ka paguar gjysëm milioni USD. Ai garantoi përkrahjen ose më së paku "neutralitetin" e kryeministrit Rama që, ndryshe nga më parë, nuk i kundërshtoi lëvizjet e ish delfinit të vet në Bashki.

Por, mbi të gjitha, duke shfrytëzuar kërkesën e Gjykatës Kushtetuese për një arsyetim të hollësishëm të proporcionalitetit të mbajtjes në burg të një të zgjedhuri lokal, ai filloi mësymjen ndaj bashkisë. Ai shkarkoi de facto zvendësen Anuela Ristani, të cilës i pati deleguar kompetencat, që si pasojë e mungesës së vet fizike të mos pengohej mbarrëvajtjen e punëve të institucionit. Por nuk u mjaftua me kaq. Ai nuk ia kaloi më askujt këtë përgjegjësi duke pretenduar se do ta drejtonte nga burgu Tiranën. Për shumëkënd kjo lëvizje që mori dhe bekimin e kryeministrit u pa si një përpjekje për të zhytur bashkinë në kaos. Jo vetëm sepse Veliaj nuk përmbushte dot anën protokollarë dhe ceremoniale të përfaqësimit të institucionit, por se nga burgu ai nuk qe në gjendje të firmoste paga, ndihma sociale dhe fonde të ndryshme që duheshin për mbarrëvajtjen e qytetit. Por ndërsa ata që shihnin interesin qytetar i trembeshin kaosit, Veliaj donte ta shfrytëzonte atë si një levë për të thyer portën e burgut. Kryeargumenti i mbrojtjes së tij qe i thjeshtë: Ai duhej të lirohej në emër të mirë administrimit të Tiranës. Nëse Kushtetuesaj kishte vendosur se ai nuk duhej shkarkuar, ai këtej e tutje duhej lejuar të kryente plotësisht detyrën.

Pra shkarkimi i Ristanit dhe mosdelegimi i kompetencave diku tjetër kishte qëllim të qartë: të përdorej si presion ndaj gjyqtarëve të lartë duke lënë mbi supet e tyre përgjegjësinë e mosfunksionimit të një kryeqyteti me gati një milionë banorë. Kjo strategji, për ta përdorur

ide!

Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?
Nga Andi Bushati

Në Shqipërinë e sotme "revolucionin" ka emrin pjesëmarrje dhe alternativë
Nga Preç Zogaj

Tej e Këtej



Tronditet Edi Rama, i kërkohej largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [kliko këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Messenger

Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori? Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

[Shiko të tjera video](#)

bashkinë si mish për top mori shumë hove edhe në mediat pro Veliaj. "si mund të penalizohet Tirana"? "Si mund të pengohen kështu punët e qytetit"? "Si mund të shpërfilllet interesi i qytetarëve", ishte refreni i tyre.

Por pavarësisht të gjithë kësaj rokopuje gjykata vendosi ta lërë Lalin në burg. Dhe tani gjithë strategjia e ngritur javët e fundit rrezikon ti shndërrohet në bumerang. Nëse deri më tani meraku paskish qenë shërbimi ndaj banorëve, përkujdesja ndaj qytetit dhe mbarvajtja e Tiranës, a nuk duhet që në emër të këtyre kauzave Veliaj të mendojë dorëheqjen?

Natyrisht kush e ka ndjekur trajektoren e tij politike, lëpirjen ndaj më të fortëve dhe arrogancën kundrejt më të dobhtëve, karkaterin dhe dyfytërsinë e tij, nuk ka as dyshimin më të vogël se për Veliajn ky nuk është një obsion. Ai do të vijojë të zvarritet edhe në qeli. Madje nuk do të jetë Çudi as ndonjë karagjozllëk i radhës, për ti deleguar te dikush tjetër kompetencat që i mori se i duheshin vetëm për ti përdorur këtë 15 shtator.

Ama një gjë është e qartë edhe për ata që, si puna ime, dyshojnë në ekzistencën e një dosjeje të konsoliduar kundër tij apo që e shohin si absurd mbajtjen kaq gjatë në izolim: qëndrimi i Erion Veliajt në detyrë është një fëlliqësi. Deri më tani për ta nxjerë atë nga burgu u përdor alibia e mos dëmtimit të interesit të qytetarëve dhe punëve të Tiranës. Këtej e tutje, pasi mirë apo keq, Gjykata e Lartë vendosi të lërë edhe për një kohë relativisht të gjatë të izoluar duhet të jesh i pafytyrë që të mbrosh idenë se Lali mund të mbetet kryebashkiak edhe në dëm të këtij interesi./Lapsi

IDE / 13 September 2026, 21:57

Në Shqipërinë e sotme "revolucionin" ka emrin pjesëmarrje dhe alternativë

Nga Preç Zogaj

IDE / 12 September 2026, 12:06

John Goci konkurren Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?

Nga Thoma Gëllçi

IDE / 7 September 2026, 14:46

"Liria punon", por duhen edhe 6 milionë dollarë!

Nga Mero Baze

IDE / 3 September 2026, 11:14

Skandali i vërtetë në rastin Veliaj

Nga Blendi Kajsiu

IDE / 30 August 2026, 10:58

Reflektimi i Ramës ndaj

IDE / 28 August 2026, 20:10

Përgatitje qesharake për

protestave, forcimi i shtet-partisë elektorale

Nga Preç Zogaj

triumfalizem

Nga Mero Baze

IDE / 24 August 2026, 22:23

Shqiptarët nuk merren me beteja të vogla, por me probleme serioze, Soros dhe Trump...

Nga Thoma Gëllçi

IDE / 21 August 2026, 17:34

Kriza në Kosovë, egoizmi primitiv që plagos Republikën

Nga Lorenc Vangjeli

IDE / 20 August 2026, 20:34

Aksidentet e turistëve të huaj që na e bëjnë më të shtrenjtë mjekësinë falas

Nga Mero Baze

IDE / 20 August 2026, 20:18

Plaku me bastun, si antimodeli ndaj një pushteti të shurdhët

Nga Andi Bushati

IDE / 13 August 2026, 16:41

Shqiptarë e serbë, më mirë nën sindromën e viktimizimit apo viktima të megalomanisë?

Nga Lorenc Vangjeli

IDE / 10 August 2026, 20:47

E reja kundër Kosovës, nuk vjen as nga Zelenski as nga Vuçiqi, por nga Perëndimi

Nga Mero Baze

IDE / 9 August 2026, 11:04

Çfarë tregon fitorja e Edlirës

Nga Thoma Gëllçi

IDE / 2 August 2026, 21:59

Kryengritja e kryetarëve që s'kanë asnjë kompetencë

IDE / 2 August 2026, 15:08

Kryeministri po flet me veten

Nga Blendi Kajsiu

IDE / 1 August 2026, 13:15

Mjekët "martirë" të Covid-it

Nga Erion Dasho

IDE / 28 July 2026, 17:56

Kriza e besimit mes pushtetit dhe qytetarëve është sfida më e madhe e demokracisë shqiptare

Alban Daci

IDE / 26 July 2026, 22:17

Një prerje në besë e Shqipërisë së re

Nga Andi Bushati

IDE / 26 July 2026, 13:57

Bulevardi i flamingove dhe Qeveria e empatisë, konspekt nga fjala e kryeministrit

Nga Thoma Gëllçi

IDE / 25 July 2026, 21:10

Pushteti dhe opozita e vjetër, si rosakë të shëmtuar dhe të plakur...

Nga Desada Metaj

KONTAKT

PRIVACY POLICY

COOKIES

NJOFTIME NGA TPZ.AL 

tpz.al

TPZ.al është një media online e pavarur. Përpjekja jonë është të sjellim lajme, analiza dhe komente, në shërbim të interesit publik.



AKTUALITET

IDE

NË FOKUS

BALLKAN

BOTA

LIFESTYLE

SPORT

TEJ E KETEJ

BLOG

EMISIONE

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.